

L I G J
Nr.7512, datë 10.8.1991

PËR SANKSIONIMIN DHE MBROJTJEN E PRONËS PRIVATE TË NISMËS SË LIRË, TË VEPRIMTARIVE PRIVATE TË PAVARUR DHE PRIVATIZIMIT

Me qëllim që të vendoset një rend i ri ekonomik dhe të zbatohet kalimi nga një sistem me ekonomi të centralizuar e të kontrolluar nga shteti, në një sistem ekonomik të bazuar në parimet e tregut të lirë, në mbështetje të neneve 10,11,12,13 dhe 16 të ligjit nr.7491 datë 29.4.1991 " Për dispozitat kryesore kushtetuese " me propozimin e Këshillit të Ministrave.

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKES SË SHQIPËRISË

V E N D O S I

Neni 1

Në Republikën e Shqipërisë sanksionohen dhe mbrohen prona private, nisma e lirë, veprimtaritë private të pavarura, afarizmi, investimet e huaja, e drejta për të marrë e për të dhënë kredi, e drejta për të punësuar e për tu punësuar privatizimi i pronës shtetërore dhe gjithë procesi i kalimit të ekonomisë së Republikës së Shqipërisë nga një ekonomi e planifikuar dhe e kontrolluar nga shteti, në një ekonomi të tregut të lirë.

Neni 2

Subjektet shqiptare ose të huaja ushtrojnë veprimtaritë private të mëposhtëme (pa u kufizuar vetëm me to):

- a) si individe;
- b) me ortakëri;
- c) me kolektiva ose kooperativa;
- ç) me formim ndërmarrjesh, shoqëri të ndryshme aksionere ose me përgjegjësi të kufizuar, anonime dhe forma të tjera të mundshme;
- d) me formim bankash, fondacionesh e institucionesh bamirësie, si dhe me forma të tjera të mundshme.

Të gjitha veprimtaritë e mësipërme rregullohen me ligj.

Neni 3

Gjithë sektorët e ekonomisë janë të lire të privatizohen dhe të ushtrojnë veprimtari private, përfshirë ndërmarrjet, institucionet dhe njësitë e tjera shtetërore, duke kaluar në pronë private në të gjitha fushat e veprimtarisë së prodhimit industrial, artizanal, të bujqësisë, të ndërtimit, të transportit, të shërbimeve bankare, të tregtisë së brendshme e të jashtme, të komunales, të shërbimeve jetësore, shkencore, të kërkimeve kulturore e artistike, të avokatise, të bamirësisë, të fondacioneve e të fushave të tjera të mundshme.

Ndërmarrjet ose njësitë e tjera shtetërore, të degëve me rëndësi të veçantë të ekonomisë kombëtare: industria e energjetikës dhe e mineraleve, e naftës dhe e gazit, postat, telekomunikacionit, pyjet dhe ujrat, rrugët automobilistike e hekurudhore, portet detare, aeroportet, transporti ajror e hekurudhor, mund të privatizohen në raste të veçanta me ligj.

Ndërmarrjet dhe njësitë shtetërore të përmendura në paragrafin e dytë të këtij neni janë të lira të krijojnë ndërmarrje të përbashkëta me kapital të huaj sipas ligjeve në fuqi.

Neni 4

Personat fizikë a juridikë private, vendas a të huaj, e ushtrojnë veprimtarinë ekonomike

private me mjetet e tyre financiare, me kredi, me aksione e forma të tjera.

Neni 5

Subjektet e përmendura në nenin 2 të këtij ligji fitojnë zotësinë për të vepruar, me regjistrimin e tyre në gjykatën e rrethit ku e ushtrojnë veprimtarinë.

Për të bërë regjistrimin, ata i paraqesin gjykatës një kërkesë, ku shënohet objekti i veprimtarisë dhe, kur është fjala për ortakëri, shoqëri et., edhe kontraten ose marrëveshjen e statutit e veprimtarisë së tyre.

Një kopje të vendimit perkates të saj gjykata ia dërgon brenda 10 ditëve, nga data që vendimi ka marrë formë të prerë, organit financiar të juridiksionit të vet dhe bën regjistrimin e pasurive të palujtshme të subjekteve.

Kur me vendim të arsyetuar të gjykatës kërkesa nuk pranohet subjektet kanë të drejtë të bëjnë ankesë brenda 10 ditëve nga shpallja e vendimit në gjykatën e shkallës së dytë, vendimi i së cilës është i formës së prerë.

Kur gjykata nuk vepron brenda 10 ditëve nga paraqitja e kërkesës, leja konsiderohet e miratuar automatikisht.

Neni 6

Personat fizikë a juridikë private, vendas a të huaj, që ushtrojnë veprimtari sipas këtij ligji, i caktojnë vetë çmimet dhe tarifat e prodhimeve e të shërbimeve, në bazë të kërkesës e të ofertes.

Për mallrat dhe shërbime, për të cilat konkurrenca është e kufizuar për shkak të situates monopol ose të vështiresive e mungesave të dukshme në furnizimin e tregut, si dhe për disa mallra e shërbime të nevojës se domosdoshme për popullsinë, Keshilli i Ministrave cakton me vendim të veçantë kufijte maksimale të çmimeve e të tarifave. Ky vendim ka fuqi deri në një vit nga data e shpalljes së tij.

Neni 7

Personat fizikë a juridikë private, vendas a të huaj për ushtrimin e veprimtarisë së tyre, e sigurojnë bazën materialo-teknike nëpërmjet kontratave me sektorët shtetërorë, drejtpërdrejtë në tregun e lirë, si dhe me persona juridikë ose fizikë vendas a të huaj, sipas legjislacionit në fuqi për eksport-importin.

Neni 8

Ministria e Financave përcakton rregulla për dokumentimin ekonomiko-financiare, për mënyrën e llogaritjes së kontributit fiskal dhe afatet e derdhjes së tij, si dhe për kontrollin e sigurimeve shoqërore të detyrueshme të sektorit privat. Ajo përcakton gjithashtu edhe kriteret e llogaritjes së fitimit për personat private fizikë e juridikë, vendas e të huaj, që ushtrojnë veprimtari private në Shqipëri.

Personat fizikë e juridikë private, vendas e të huaj në ushtrimin e veprimtarisë së tyre mbajnë kontabilitet të rregullt dhe regjistrat përkatës sipas ligjit të veçantë.

Neni 9

Personat fizikë a juridikë private, vendas e të huaj, kanë të drejtë të çelin llogaritë përkatëse pranë bankave të vendit e të huaja në Shqipëri dhe të kryejnë veprimet e likuidimit nëpërmjet tyre.

Personat fizikë e juridikë private, vendas dhe të huaj, paraqesin bilanc vjetor së bashku me deklaratën e të ardhurave, të humbjeve e fitimeve dhe i depozitojnë ato në organin financiar të juridiksionit ku ushtrojnë veprimtarinë e tyre.

Neni 10

Veprimtaria private me ortakeri krijohet nga bashkimi i kapitaleve të dy ose me shumë individëve shqiptarë ose të huaj. Marrëdhëniet ekonomike e financiare rregullohen në bazë të kontratës që lidhet ndërmjet tyre. Në kontrate shënohet objekti i veprimtarisë, kapitali i derdhur nga secili anëtar, pjesa e fitimit të çdo ortaku në pjestim me kuoten e dhënë, kohëzgjatja e ortakërisë e mënyra e likuidimit të saj dhe elementë të tjera.

Ortakët janë solidar si për të drejtat, ashtu edhe për detyrimet që burojnë nga kontratat e ortakërisë, kur është fjala për shoqëri ndërmjet individëve.

Neni 11

Veprimtaria private me kolektiva ose kooperativa tregtare, prodhuese, të shërbimeve etj, ushtrohet në përputhje me statutin dhe rregulloren e miratuar prej tyre. Në këto dokumente duhet të përcaktohen objekti i veprimtarisë, masa e pjesëmarrjes në kapital, mënyra e organizimit dhe e drejtimit, forma e shpërndarjes të të ardhurave ndërmjet anëtarëve, rregullat e punësimit e të pagesës së punonjësve jo anëtare, si dhe rregullat e tjera që kanë të bëjnë me detyrimet ekonomiko-financiare.

Neni 12

Ndërmarrjet ose shoqëritë e ndryshme aksionere e të tjera si këto, që krijohen me kapitale monetare e materiale, sipas rastit, me një ose disa individë shqiptarë a të huaj, si dhe me aksione, e zhvillojnë veprimtarinë e tyre në bazë të kontratës së themelimit, të statutit ose të rregullores që miratohet prej tyre e ku përcaktohen objekti i veprimtarisë, kapitali themelor, drejtimi administrativ, marrëdhëniet ekonomiko-financiare, ato kontraktore, të punësimit dhe elemente të tjera.

Neni 13

Ndërmarrjet e përbashkëta që krijohen ndërmjet ndërmarrjeve ose njësive shtetërore me subjekte private të huaja, me subjekte private vendase ose vendase e të huaja, e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në bazë të kontratës e të statutit të miratuar prej tyre dhe të dispozitave përkatëse ligjore.

Neni 14

Personat private juridikë a fizikë, vendas a të huaj, mund tu kalojnë në pronësi ose tu japin me qira personave të tjerë fizikë a juridikë, vendas a të huaj, ndërmarrjet, njësi ose objekte të ndryshme sipas kontratës së veçante që do të lidhet ndërmjet tyre.

Kalimi në pronësi ose dhënia me qira e truallit, mbi të cilin ngrihen këto objekte, rregullohet me nenin 21 të këtij ligji.

Neni 15

Veprimtaritë private ushtrohen në përputhje me dispozitat në fuqi për standardet e cilesinë, për kontrollin e mjeteve matëse e saktësinë e matjes, higjenën, kushtet e punës, sigurimin teknik, mbrojtjen e mjedisit etj dhe kontrollohen nga organet shtetërore të ngarkuara me detyra në këto fusha.

Neni 16

Ministria e Lidhjeve Ekonomike me Jashtë në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe në fillim të çdo viti, të përcaktoje kontigjentimin e mallrave të eksport importit.

Neni 17

Personat e huaj që ushtrojnë veprimtari ekonomike, kanë të drejtë të transferojnë jashtë shtetit kapitalin dhe pjesën e tyre të fitimit në valute.

Personat fizikë a juridikë private që ushtrojnë veprimtari ekonomike në bazë të këtij ligji, kanë të drejtë të vetëfinancohen në lekë e në valutë të huaj.

Shkëmbimi i monedhës shqiptare me monedhë të huaj dhe anasjelltas bëhet në përputhje me kursin e caktuar nga Banka e Shtetit Shqiptar, ose në tregun e lirë privat të valutave.

Personat fizikë a juridikë, vendas a të huaj, kanë të drejtë të marrin kredi në lekë dhe në valute nga Banka e Shtetit Shqiptar ose nga bankat e tjera, shtetërore a private, vendase a të huaja.

Neni 18

Marrëdhëniet e punësimit në veprimtari të private rregullohen me kontratën që lidhet lirisht ndërmjet palëve. Për çështjet që nuk parashikohen në kontratën e punës, zbatohen dispozitat e legjislacionit të punës.

Neni 19

Marrja në punë e punonjësve bëhet nga vetë punëdhënësi privat, me regjistrimin e tyre në librin e ndërmarrjes, duke njoftuar edhe organet e punës të juridiksionit ku e ushtron veprimtarinë.

Në veprimtarinë private, punëdhënësit janë të detyruar të sigurojnë punonjësit që punojnë për ta. Këta të fundit fitojnë të gjitha të drejtat në bazë të ligjit " Për sigurimet shoqërore shtetërore të Republikës së Shqipërisë ".

Neni 20

Punonjësit që mund të dalin të tepërt nga procesi i privatizimit të sektorit shtetëror, trajtohen sipas dispozitave të veçanta për ndihmë sociale.

Neni 21

Personave fizikë a juridikë private vendas u jepet në pronesi trull për ndërtim me pagesë, duke pasur edhe të drejtën e shitblerjes.

Personave fizikë a juridikë të huaj u jepet truall për ndërtim nga personat fizikë a juridikë vendas vetëm me qira për një periudhë deri në 49 vjet, sipas një kontrate të veçante.

Çmimi i shitjes dhe qiraja e truallit për ndërtim, që është pronë shtetërore, caktohen nga organi financiar i pushtetit lokal në juridiksionin e të cilit ndodhet trualli, sipas kriterëve të caktuara nga Këshilli i Ministrave dhe sipas kërkesës e ofertës.

Shitja dhe dhënia me qira e truallit ër ndërtim bëhet nga organi financiar i lartpërmendur. Shumat e paguara për truallin destinohen e përdoren për zhvillimin e infrastrukturave të juridiksionit të pushtetit lokal.

Personat juridike a fizike vendas pronare të ndërtesave ekzistuese të çdo lloji janë edhe pronarë të truallit që zënë këto ndërtesa. Kur këto të fundit blihen nga të huajt, ata kanë të drejtën e pronësisë vetëm për ndërtesën kurse toka mbi të cilën ngrihet ndërtesa, u jepet me qira sipas paragrafit të dytë të këtij neni.

Neni 22

Për kalimin e pronës shtetërore në pronë private krijohet Agjensia Kombëtare e Privatizimit pranë Këshillit të Ministrave, e cila është kompetente për drejtimin, organizimin dhe bashkërendimin e punës për procesin e privatizimit. Ajo jep autorizimin, shpall formën, cakton kohën dhe rradhën e kalimit të objekteve të pronës shtetërore në pronë private.

Agjensia Kombëtare e Privatizimit bashkëpunon me Komisionin Përgatitor të Procesit të Privatizimit pranë Ministrisë së Ekonomisë. Ky komision bashkërendon punën me nënkomisionet e privatizimit që ngrihen pranë ministrive, institucioneve të tjera qendrore dhe organeve të pushtetit lokal për vlerësimin e objektit dhe përgatitjen e dokumentacionin përkatës, i cili i paraqitet Agjensisë Kombëtare të Privatizimit. Kjo agjensi ka kompetencën e dhënies me qira të objekteve që janë pronë shtetërore.

Neni 23

Kalimi i pronës shtetërore në pronë private behet nëpërmjet ankandit, shitjes së lirë të aksioneve, dhënies falas të aksioneve shtetërore personave fizikë vendas, si dhe me çdo mënyrë tjetër të përshtatshme.

Vlerësimi i pronës shtetërore që do të privatizohet, bëhet duke patur parasysh edhe gjendjen fizike, vendndodhjen dhe karakterin e prodhimit a të shërbimit të objektit.

Prona shtetërore që privatizohet, të mos e ndryshojë destinacionin e vet për dy vjet. Ndryshimi i destinacionit brenda këtij afatit mund të bëhet me lejen e Agjensisë Kombëtare të Privatizimit.

Neni 24

Ankandi organizohet dhe shpallet nga Agjensia Kombëtare e Privatizimit. Ai është i hapur, i lirë dhe i barabartë për të gjithë. Pjesëmarrësit në ankand duhet të paraqesin dokumente të formave të ndryshme të njohura me ligj, që vërtetojnë aftësinë e tyre paguese.

Fillimisht në ankand lejohet të marrin pjesë vetëm persona fizikë e juridikë me shtetësi shqiptare. Nëse objekti nuk shitet në seancën e dytë të ankandit, me miratim të Agjensisë Kombëtare të Privatizimit, në ankand marrin pjesë edhe persona fizikë e juridikë të huaj.

Vlerësimi dhe shitja e mjeteve të xhiros bëhet me çmimet aktuale shtetërore me shumicë në momentin e shitjes.

Pronari i shpallur nga ankandi fiton të drejtën e pronësisë me pagesën tërësore të vleftës së objektit ose me pagesën pjesore të kësaj vlefte. Kur pagesa bëhet pjesore, pjesa e mbetur e vleftës së objektit u shpërndahet falas ose u shitet punonjësve të objektit në formë aksionesh. Pjesa e vleftës së objektit që u shpërndahet falas ose u shitet punonjësve, caktohet nga Agjensia Kombëtare e Privatizimit. Pjesa e vleftës së objektit që shpërndahet falas, nuk duhet të kalojë 30 për qind të kësaj vlefte.

Neni 25

Privatizimi i pronës shtetërore nëpërmjet shitjes së aksioneve organizohet dhe shpallet nga Agjensia Kombëtare e Privatizimit, që përcakton edhe vleftën nominale të aksionit.

Rregullat për emetimin, shpërndarjen, ruajtjen dhe shitjen e aksioneve përcaktohen nga Ministria e Financave, në bashkëpunim me Bankën e Shtetit Shqiptar.

Neni 26

Mosmarrëveshjet për marrëdhëniet e debitoreve dhe kreditorëve shtetërore e private, që rezultojnë në momentin e kalimit të pronësisë së ndërmarrjes ose njësive shtetërore në pronë private, zgjidhjen në marrëveshje ndërmjet palëve dhe, kur kjo nuk arrihet zgjidhen nga gjykata.

Neni 27

Të ardhurat e realizuara nga kalimi i pronës shtetërore në ate private derdhen në buxhetin e shtetit.

Neni 28

Investimet e huaja dhe prona private e personave fizikë a juridikë, vendas a të huaj, në teritorin e Republikës së Shqipërisë, nuk mund të shpronësohen ose shtetëzohen dhe as nuk mund të jenë objekt masash të tjera të barasvlefshme me shtetëzimin ose shpronësimin me përjashtim të rasteve të veçanta në interes të përdorimit publik dhe gjithmone me pagese dhe me një zhdëmtim të plotë.

Zhdëmtimi, në rastet e përmendura, në paragrafin e parë të këtij neni, do të jetë i barabartë me investimin ose vleftën e pronës së shpronësuar ose shtetëzuar ditën në të cilën i është njoftuar shpronësimi palës që do të shpronësohet dhe ky zhdëmtim do të paguhet pa vonesë, bashkë me

interesat bankare të akumuluara deri në ditën e pagimit. Zhdëmtimi është plotësisht i realizueshëm dhe lirisht i tjetërsueshëm.

Në rast se pagimi i zhdëmtimit vonohet ky i fundit paguhet me një shumë që e ve personin fizik a juridik vendas a të huaj në një pozitë jo më pak të favorshëm nga ajo që ka pasur, në qoftëse kjo shumë do të derdhej në datën e shpronësimit ose të shtetëzimit. Kushtet për mënyrën e derdhjes së këtij zhdëmtimi duhet të caktohen para datës së shpronësimit ose shtetëzimit.

Neni 29

Ligjshmëria e shpronësimit ose e shtetëzimit apo e çdo mase tjetër të barazvlefshme me to, si dhe shuma e zhdëmtimit mund të jenë objekt shqyrtimi nga gjykata.

Neni 30

Dekreti nr.7476, datë 12.3.1991 "Për lejimin dhe mbrojtjen e pronës e të veprimtarive private" si dhe të gjitha dispozitat e tjera që vijnë në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 31

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.22, datë 15.8.1991 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ramiz Alia